

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sekretari i Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve akuzon përfaqësuesen demokrate Ilhan Omar se “është martuar me vëllanë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/sekretari-i-sigurise-kombetare-te-shba-ve-akuzon-perfaqe-suesen-demokrate-il-i585592
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 11:25:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 13:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4ae6aaa2cd050430c558c1c8bfb87d2a63c2e51e90e99921f0bec8d069ae0909
TEKSTI	0c4233ce608c00db02e4b5393e608f45e109870647d249bd8a31bd920645e794
PAMJA	082b833a4c4f0def8eeec2bb8c8998bc08add99ab5c762600ae312a4fb3bb58c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cbee5c87261d89a106ef55774dee555de60b1734c6f55ef1bf2735194790c108
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cbee5c87261d89a106ef55774dee555de60b1734c6f55ef1bf2735194790c108>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e Trump takohet me lideret irlandezë, protesta kundër lutes në Iran“Drejtësia po godet rendin kushtetues”. Çupi: Gjyqësori në Shqipëri është mësuar me para në xhepNis sezoni i ri në TKOBSHB? fundit

Sekretari i Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve akuzon përfaqësuesen demokrate Ilhan Omar se “është martuar me vëllanë

12 Shtator 2026, 15:00Bota TEMA



Sekretari i Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve akuzon

Sekretari i Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, Mark Wayne Mullin, ka pohuar se kongresmenja Ilhan Omar u martua me vëllain e saj për ta ndihmuar atë të emigronte në Shtetet e Bashkuara.

Autoritetet amerikane po e shqyrtojnë çështjen dhe ministri la të hapur mundësinë e deportimit të deputetes nëse vërtetohet se ajo ka dhënë informacion të rremë gjatë procesit të natyralizimit.

Ilhan Omar ka hedhur poshtë kategorikisht akuzat për lidhje farefisnore me ish-bashkëshortin e saj, duke i quajtur akuzat ofenduese dhe të motivuara politikisht.

Hetimi i autoriteteve mbetet në vazhdim, ndërsa ministri theksoi se çdo veprim ligjor duhet të bazohet vetëm në prova faktike dhe jo në motive politike.

Polemika e gjatë rreth të kaluarës së emigracionit të përfaqësueses demokrate Ilhan Omar po merr një dimension të ri, pasi Sekretari i Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, Mark Wayne Mullin, pretendoi se politikanta e Minesotës “u martua me vëllanë e saj” për ta ndihmuar atë të emigronte në SHBA, madje duke lënë të hapur mundësinë e deportimit të saj nëse vërtetohet se ajo e bëri këtë ilegalisht.

Duke folur me podkasterin konservator Benny Johnson në margjinat e konventës republikane për zgjedhjet e mesit të mandatit në Dallas, Mullin pretendoi se autoritetet amerikane po e hetojnë rastin dhe u shfaq i bindur në pretendimin kontrovers. “Ne e dimë që ajo u martua me vëllanë e saj për të provuar ta sillte atë në Shtetet e Bashkuara”, tha ai, duke shtuar se ish-burri i Omarit aktualisht jeton në Londër.

Sipas ministrit, hetimi nuk kufizohet vetëm në këtë martesë të veçantë, por mund të shtrihet edhe në rrethanat në të cilat anëtarët e familjes së Omarit emigruan në SHBA.

“Mund të ketë më shumë në këtë rast, për sa i përket imigracionit të përgjithshëm familjar dhe ndoshta disa aktiviteteve të paligjshme në lidhje me mënyrën se si ata erdhën në Shtetet e Bashkuara në radhë të parë”, tha ai.

Malin madje la të hapur mundësinë që çështja të ketë pasojë edhe për shtetësinë amerikane të Omarit, nëse autoritetet vërtetojnë se janë dhënë informacione të rreme gjatë procesit të imigracionit ose natyralizimit.

“Nëse keni gënhyer për gjëra specifike në aplikimin tuaj, kjo nuk është e parashkruar. Nëse mund të vërtetohet se nuk duhet të ishit këtu që në fillim, do t’ju deportojmë”, tha ai.

Në të njëjtën kohë, ai nxitoi të theksonte se hetimi është ende duke vazhduar dhe se çdo vendim për të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore duhet, siç tha ai, të bazohet në prova faktike dhe jo në motive politike.

“Nëse do të ecim përpara me një çështje, dua të sigurohem që kjo të mos jetë një çështje politike, por një çështje e vërtetë, sepse dikush bëri diçka të paligjshme”, tha ai.

Omar, i cili lindi në Somali, u bë shtetas amerikan në vitin 2000, në moshën 17 vjeç.

Martesa e diskutueshme dhe ankesat

Akuzat përqendrohen tek Ahmed Noor Said Elmi, me të cilin Omar u martua ligjërisht në shkurt të vitit 2009. Ajo e ka mohuar vazhdimisht dhe me forcë se Elmi është vëllai i saj. “Sugjerimet se Ahmed Noor Said Elmi është vëllai im janë absurde dhe fyese”, tha ajo në vitin 2016.

Omar e ka përshkruar marrëdhënien e saj me Elmi-n si të shkurtër, duke pretenduar se ata ishin të larguar për pjesën më të madhe të martesës së tyre. Martesa e tyre u shpërbë

zyrtarisht ne vitin 2017.

Një muaj më vonë, në janar 2018, Omar u martua ligjërisht me Ahmed Abdisalan Hirsi, me të cilin kishte pasur më parë fëmijë.

Akuzat se Omar dhe Elmi ishin vëllezër e motra kishin qarkulluar të paktën që nga mesi i viteve 2000, fillimisht në komunitetet online të diasporës somaleze.

Në vitin 2020, blogeri somalez dhe aktivisti i komunitetit të Minesotës, Abdihakeem Osman, pretendoi se e kishte njohur Omarin nga vitet e tyre të rritjes në Minesota dhe se ajo ua prezantoi Elmin anëtarëve të komunitetit si vëllain e saj nga Londra. Ky është një pretendim që kongresmenja e ka mohuar.

Trump dhe Vance e kanë rihapur çështjen

Çështja është rishfaqur në debatin politik në muajt e fundit, me Donald Trump dhe zëvendës-presidentin J.D. Vance që gjithashtu kanë përqafuar publikisht akuzat për mashtrim me imigracionin.

Vance tha në mars se beson që Omar “ka kryer mashtrim me imigracionin kundër Shteteve të Bashkuara”, ndërsa Trump ka thënë publikisht se beson që kongresmenja demokrate “u martua me vëllain e saj”.

Omar ende nuk është dënuar për mashtrim me imigracionin dhe ajo i ka quajtur akuzat të motivuara politikisht.

Mashtrimi martesor është një krim federal në Shtetet e Bashkuara dhe mund të dënohet me burg deri në pesë vjet dhe me gjobë deri në 250,000 dollarë.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Trump takohet me liderët irlandezë, protesta kundër luftës në Iran](#)

13:20 Bota

["Tajlanda nuk është në shitje" - Në Bangkok nisin protestat para Ambasadës së Israelit!](#)

12:10 Bota

[Putin: Gabimet e Perëndimit çuan në ngritjen e AfD-së](#)

11:00 Bota / 2 komente

[Protesta për aeroportin Mezzeh në Damask, banorët kërkojnë të drejtat mbi tokën](#)

10:50 Bota

[Lufta në Ukrainë vijon, por pse ka rënë numri i refugjatëve ukrainas në Poloni?](#)

10:40 Bota / 2 komente

[Rritja e prodhimit të naftës dhe gazit, Meloni: Duhet të shfrytëzojmë burimet tona energjetike](#)

10:20 Bota

[Miratimi për punën e Presidentit Trump nga votuesit e tij në pikën më të ulët](#)

10:14 Bota

[Trump 'hap derën' për prodhuesit kinezë të automjeteve: Mund të prodhojnë në SHBA nëse punësojnë amerikanë](#)

09:50 Bota / 1 koment

[Një ish-oficer i Stasi-t, një ish-aktor filmash pornografikë dhe persona nën hetim për lidhje neo-naziste: Kush janë deputetët e rinj të AfD-së](#)

09:30 Bota / 2 komente

[Shpërthen në depoja e armëve në Bullgari, kompania ishte më herët objekt i sabotimeve të dyshuara ruse](#)

09:20 Bota / 1 koment

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë](#)

16:18 Politika / 48 komente

[Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës investon 2 milionë euro ...](#)

13:45 Sociale / 3 komente

["Në emrin tim flas vetëm unë"/ Rama për arrestimin e Agas...](#)

22:46 Politika / 28 komente

[Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare](#)

17:00 Editorial / 20 komente

["Për dosjet e qytetarëve vite pritje, për pagat e veta Gj...](#)

16:23 Politika / 51 komente

Blog Tema

[John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?](#)

11:40 Blog

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:25 Blog / 2 komente

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:00 Blog / 1 koment

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

REGJISTROHU

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Politika• Kronika• Editorial• Blog• Bota• Sport• Shëndeti• Turizëm | <ul style="list-style-type: none">• Sociale• Ekonomia• Antena• Rajoni• Kulturë• Lifestyle• Dossier• Hi-Tech |
| <ul style="list-style-type: none">• Kontakt• Te dhënat personale• Cookies | |

Built and Monetized by